



## **BANKA E SHQIPËRISË**

# **KONFERENCË PËR SHTYP** **e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë** **z. Shkëlqim Cani** **23 janar 2002**


## **I. Zhvillimet në çmimet e konsumit në vitin 2001.**

Indeksi i çmimeve konsumit në fund të vitit 2001 arriti në 237.66. Inflacioni në fund të vitit arriti në 3.5 për qind. Në këtë mënyre Banka e Shqipërisë deklaroi se edhe për vitin 2001 siguroi respektimin e objektivit të inflacionit, megjithëse disa fenomene të ndodhura gjatë tij ishin të tilla që vunë në dyshim këtë objektiv.

Karakteristikë e përgjithshme e vitit 2001, janë lëkundjet jo të rregullta që pësoi norma vjetore e inflacionit gjatë rrjedhës së muajve duke kulmuar në muajin korrik me 5.61 për qind, ndërkohë që vlera më e ulët negative e tij është regjistruar në muajin shkurt me 1.46 për qind. Mesatarisht, gjatë gjithë vitit 2001, inflacioni i matur me normën dymbëdhjetë mujore të tij ka shënuar vlerën 3.1 për qind.

### **I.1. Zhvillimet në muajin dhjetor.**

Norma e inflacionit e rezultuar në muajin dhjetor ishte 5.3 për qind. Ky muaj konfirmoi pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë për rritje të konsiderueshme, të çmimeve të konsumit. Për më tepër, Banka e Shqipërisë vëren që ky fenomen po përsëritet nga njëri vit në tjetrin. Por, më e theksuar është në dy vitet e fundit, duke marrë kështu trajtat e një ngjarjeje të zakonshme të karakterit sezonal.



Më konkretisht, rritja e dukshme e vlerës së inflacionit në muajin dhjetor vjen si rezultat i rritjes, shpesh spekulative, të çmimeve të grupit “ushqim, pije dhe duhan” me rastin e festave të fundvitit. Kështu, rritja e çmimeve në këtë grup me **6.4 për qind** dha një ndikim prej **4.4 për qind** në rritjen e IÇK. Brenda këtij grupi, nëngrupi “fruta dhe perime” shënoi një rritje prej **19.8 për qind**, rritje në të njëjtat vlera me atë të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Karakteristikë e dhjetorit të vitit 2001 është rritja e çmimit të energjisë mbi 300 kwh me **50 për qind**, që çoi në rritjen me 6.3 për qind të indeksit të grupit “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”. Megjithë peshën e vogël që zë ky grup në llogaritjen e përgjithshme të IÇK (bëhet fjalë për peshat në llogaritjen e IÇK me bazë vitin 1993), ai ka ndikuar në rritjen e tij me gati **një për qind**.

Grupet e tjera kanë ndikuar shumë pak në rritjen e indeksit të përgjithshëm, megjithëse grupi “kujdesi mjekësor” shënoi një rritje **1.1 për qind** gjatë këtij muaji.

Duke përgjithësuar sa më sipër zhvillimet e inflacionit që i takojnë fundvitit 2001, do t’i konsideronim ato si produkt të disa faktorëve:

- Rritja spekulative dhe dalja nga kontrolli e çmimeve për shkak të festave të fundvitit. Ndoshta, në një pjesë të saj rritja spekulative e çmimeve, është ndikuar edhe nga situata e rënduar dhe e paqëndrueshme politike në vend, duke u stimuluar kështu nga efekti psikologjik;
- rritja e çmimit të energjisë elektrike;
- ashpërsimi i krizës energjitike;
- rritja e çmimeve të mallrave të konsumit, sidomos në zonat e bllokuara për shkak të temperaturave të ulëta të motit.

Të gjithë këta faktorë vlerësohet se kanë ndikuar dukshëm në kahun rritës të inflacionit, ndërkohë që faktorë të tillë si:

- mbiçmimi i monedhës së vendit;
- rënia e vazhdueshme e çmimeve të produkteve bujqësore dhe naftës në tregun botëror;
- shpenzimet buxhetore, që nuk shënuan rritjen e zakonshme të fundvitit;

rezultuan me ndikim më të dobët dhe nuk arritën të zbutnin disi efektin e fundvitit. Pra, duke krahasuar efektet e dy grupeve të faktorëve vlerësohet se ndikimi i grupit të parë është i drejtëpërdrejtë dhe i shpejtë.

## I.2. Kategoritë e inflacionit.

Gjatë vitit 2001, shpeshherë Banka e Shqipërisë ka cituar se lëvizjet që kanë prodhuar inflacion në të shumtën e rasteve janë produkte të goditjeve që pëson oferta agregate. Me anë të kësaj është hedhur poshtë prania e një inflacioni kronik dhe të qëndrueshëm që shkaktohet në mënyrë “tradicionale” nga lëvizjet në anën e kërkesës agregate.


Gjatë gjithë vitit të kaluar është theksuar vazhdimisht ndikimi negativ që pritet të ketë kriza energjitike, në formën e reduktimit të kapaciteteve prodhuese, duke bërë që ana e ofertës të ulet ndjeshëm dhe të mos jetë në gjendje të përballojë kërkesën për energji, e cila për shkaqe tashmë të njohura në këtë pjesë të vitit tenton të rritet në mënyrë të vazhdueshme. Po kështu ndodhi dhe në stinën e verës kur u soll si argument kriza në Maqedoni, e cila kishte ndikuar drejtëpërdrejt në mosrealizimin e kuotave të kërkuar të importeve për mallra dhe produkte ushqimore, gjë që mendohet se ka çuar përsëri në një mospërputhje midis ofertës dhe kërkesës për këto grupe mallrash. Rritja administrative e çmimeve të kontrolluara, gjithashtu, nuk konsiderohet si një faktor që prodhon inflacion të qëndrueshëm. Ajo vlerësohet të japë një ndikim të plotë në periudhën kur merr jetë dhe më tej ajo shuhet<sup>1</sup> automatikisht.

Në këtë mënyrë, për të shprehur më mirë atë pjesë të inflacionit, që është kontribut i politikave ekonomike dhe monetare Banka e Shqipërisë i përqendron analizat e saj edhe te kategori të tjera të inflacionit, ku mbi të gjitha spikat inflacioni bazë.


**Inflacioni bazë**, pas një periudhe tejet të gjatë në nivele të ulta, afërsisht zero, në muajin dhjetor 2001, për herë të parë ka shënuar nivelin 1.08 për qind në bazë vjetore. Megjithëse nivelet e aktuale janë të ulëta dhe larg pragut të të qenurit alarmant, ekziston një prirje e qartë në rritje.

---

<sup>1</sup> Megjithatë, në rastin konkret meqenëse çmimi i energjisë është pjesë e kostos ajo do të pasqyrohet ndoshta dhe për një periudhë ose maksimumi dy periudha para se të shuhet fare.




**Inflacioni përjashtuar zërin “fruta, perime”** përfaqëson një tjetër kategori, e cila synon të zbusë ndikimin që ushtrojnë në inflacion zëra të kësaj natyre me efekte të forta stinore. Shpeshherë, në shumicën e viteve të tranzicionit, me të drejtë inflacioni është identifikuar me ndryshimin e çmimeve të grupit fruta dhe perime. Po ta zhveshim shportën e artikujve nga ky grup, inflacioni vjetor, me përjashtim të muajit dhjetor 2001, gjatë gjithë kohës qëndron në nivele të ulëta që luhaten në intervalin  $\pm 1$  për qind. Megjithatë, dhe në muajin dhjetor 2001, ndryshe nga inflacioni aktual, përqindja vjetore në fund të vitit shënon vetëm 1.24 për qind, rreth 3 pikë përqindjeje më pak.



**Inflacioni sipas shportës së re**, një përjashtje tjetër e cila, për momentin, gjykohet se është më afër realitetit të ditëve të sotme, është dhe matja e inflacionit ku pesha<sup>2</sup> e grupit “ushqim, pije dhe duhan” zbritet nga 72.3 për qind në vetëm 50 për qind. Ndryshimi vjetor i indeksit të përftuar nga kjo kategori është në kufij të ulët, poshtë vlerës 2 për qind.

<sup>2</sup> Siç do të konstatohet shumë shpejt nga shpallja e shportës së re të artikujve nga ana e INSTAT, pesha e grupit “ushqim, pije dhe duhan” është shumë afër këtij realiteti.



### I.3. Objektivi për vitin 2002.

Në dokumentin e politikës monetare për vitin 2002, është përcaktuar objektivi për inflacionin në kufijtë 2-4 për qind. Bazuar në zhvillimet e deritanishme dhe në pritshmëritë për vitin 2002, Banka e Shqipërisë e quan këtë objektiv të arritshëm dhe të përshtatshëm për të vijuar me stabilitetin e çmimeve dhe për të mbështetur rritjen ekonomike.

Megjithatë, gjej me vend të tërheq vëmendjen qysh në fillim të vitit për një sërë faktorësh të cilët mund të krijojnë përsëri shqetësime. Si të tillë faktorë përmendim:

- ashpërsimi më i thelluar i krizës energjitike – siç dihet këtë rradhë nuk i kanë shpëtuar edhe industritë e mëdha dhe kjo situatë mund të ngrëjë pikëpyetje serioze mbi ecurinë e prodhimit vendas në një kontekst më afatgjatë. Gjithësesi, kohëzgjatja e krizës aktuale do të ketë një rëndësi të madhe për ndikime të mundshme negative mbi ecurinë e prodhimit të përgjithshëm bruto të vendit;
- ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë do të ndihet të paktën në tre muajt e parë të këtij viti. Natyrshëm pritet që ky efekt të vijë i plotë në periudhën që vijon, duke u shfaqur kryesisht në korrigjimin e çmimeve të ofruara nga biznesi për të përballuar kostot shtesë të mundshme;
- vendosja e taksave më të larta për biznesin e vogël, gjykohet të shkaktojë rritjen e çmimeve, kryesisht, për sektorin e shërbimeve;
- moti i keq i kësaj periudhe, i cili ndikon në bllokimin e qarkullimit të mallrave dhe mund të çojë në rritje të çmimeve;
- rishpërthimi i konfliktit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, po ashtu mund të shkaktojë një efekt të ngjashëm me atë të vitit 2001.

## II. Euro: Si u prit ajo në tregun shqiptar.

Të gjithë jemi dëshmitarë të asaj ç'ka ndodhi në Europë dhe më gjerë në fillim të këtij viti. Bankat gjithandej, prej disa muajsh kishin marrë masat për të përballuar kërkesat e klientëve për monedhën më të re-euron. E njëjta gjë ndodhi edhe në Shqipëri siç jemi njoftuar gjatë kontakteve paraprake me bankat e nivelit të dytë. Nisur nga pozitat e bankës qendrore, me qëllim që të monitorojmë ecurinë e hyrjes fizike të kësaj monedhe, siç edhe jemi angazhuar në fillim të fushatës për euron, ne kemi ndjekur nga afër procesin e konvertimit të valutave në bankat tregtare të vendit. Në vija të përgjithshme është konstatuar se nuk ka patur vështirësi në furnizimin me euro *cash*. Kjo gjë, përveçse nga komentet e ekspertëve të bankave tregtare mund të konstatohet edhe nga fakti që asnjë prej bankave të nivelit të dytë nuk i është drejtuar Bankës së Shqipërisë për të përballuar vështirësitë e papritura.

Propagandimi dhe informacioni që ka arritur publikun shqiptar nëpërmjet mediave të shkruara dhe televizive gjatë muajve të fundit të vitit të kaluar, ka bërë që ky i fundit t'u drejtohet bankave për të "hequr qafe" valutat e shportës euro, duke konvertuar llogaritë në monedhën e përbashkët. Banka e Shqipërisë është e mendimit se fushata e euros ka dhënë frytet e pritshme. Për këtë arsye, mendohet se pjesa më e madhe e konvertimeve janë kryer në muajt nëntor - dhjetor 2001 dhe janar 2002. Muaji shkurt i këtij viti pritet të mos karakterizohet nga flukse të larta prurjesh të valutave të dyta dhe rrjedhimisht kërkesash për euron. Sidoqoftë bankat tregtare shprehen se ato kanë teprica të patërhequra në euro fizike. Përderisa interesimi i publikut ka qenë i kënaqshëm, fakti i mësipërm dëshmon që masat e marra nga bankat tregtare për pajisjen me monedhë fizike janë të mjaftueshme dhe se publiku shqiptar nuk do të "vuajë" mungesën e monedhës së re.

Përsa u përket komisioneve të aplikuara nga bankat tregtare për konvertimin e valutave të dyta në euro, ato variojnë nga 1-3 për qind. Komisionet më të larta vendosen nga bankat që import-eksportin e valutës e kanë zgjidhur nëpërmjet bankave të tjera, duke paguar kështu një kosto të lartë për transportin. Një pjesë e bankave ofrojnë komisione të ulëta (nën 1 për qind) për klientët e rregullt dhe për shuma të mëdha. Nga ana tjetër, duhet patur parasysh që bankat tregtare kanë përballuar një punë të konsiderueshme që ka të bëjë me përshtatjen e procedurave kontabile të çdo banke dhe të llogarive të tyre me monedhën e re si dhe të gjitha implikimet që sjell prezantimi i saj për konvertimin, llogaritjen e interesave etj..

Pavarësisht se interesimi i publikut për të tërhequr valutat përbërëse të euros (GRD, DEM, ITL) është i ulët, ka banka që vazhdojnë ta ofrojnë këtë shërbim duke u shprehur se ato janë në treg për të plotësuar kërkesat e klientëve.

Duke qenë se adoptimi e euros si monedha fizike e një zone të gjerë dhe të fuqishme ekonomike, ishte i pari i llojit të vet, ai u prit, krahas entuziazmit, me pikëpyetje dhe pasiguri. Edhe në Shqipëri, gjatë muajve të fundit të vitit të kaluar gazetat dhe publiku i gjerë vinin theksin mbi nevojën e publikut për siguri ndaj spekulimeve dhe falsifikimeve të monedhave. Në qoftë se bëjmë një analizë të ecurisë së kursit të këmbimit lek/euro për periudhën dhjetor 2001- mes janari 2002, do të shikojmë se fundi i vitit, ashtu siç pritej, u karakterizua nga një nënçmim i euros, i shkaktuar nga futja në tregun shqiptar e një sasive të madhe valutash europiane. Kjo mbiofertë detyrimisht ushtron presion mbi çmimin e valutave dhe rezulton në ngritje të çmimit të lekut kundrejt tyre. Që nga data 3 janar e këtij, me ndalimin e fluksit të valutave europiane si dhe nën ndikimin e pranisë fizike të monedhës së re, ajo ka nisur të mbiçmohet kundrejt lekut.

Megjithatë, mbetet akoma për t'u bërë nga Banka e Shqipërisë, nga bankat tregtare, nga media dhe nga publiku në lidhje me ndërgjegjësimin, dobitë dhe problemet që mund të rrjedhin prej adoptimit fizik të euros.